

## **Burimet e Ripërtërithme të Energjisë (BRE)**

### **Korniza ligjore**

- Ligji Nr. 03/L-184 për Energjinë
- Ligji Nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë
- Ligji Nr. 03/L-201 për Energjinë Elektrike

### **Strategjia**

- Strategjia e Energjisë (2009 – 2018);
- Programi për Zbatimin e Strategjisë së Energjisë të Kosovës (2009-2011)
- Plani i Kosovës për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë (PKBRE) (2011-2020)

### **Korniza institucionale**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE):

Roli:

- hartimi i politikës zhvillimore të BRE
- hartimi i planit të veprimit për BRE
- mbikëqyrja e zbatimit të politikave për BRE
- përcaktimi i caqeve të BRE.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE)

Roli:

- zbatimi i kornizën rregullative
- Përcaktimi i feed-in tarifave
- lëshimi, modifikimi, pezullimi apo tërheqja e licencave/autorizimit
- përgatitja e metodologjisë tarifore,
- hartimi i procedurave të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë,
- lëshimi i certifikatës së origjinës;
- sigurimi që tarifat e transmisionit dhe shpërndarjes për kyçje dhe shfrytëzim të sistemeve të transmisionit dhe të shpërndarjes, të mos diskriminojnë energjinë elektrike me prejardhje nga BRE

## Operatori i Sistemit të Bartjes (KOSTT) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH)

Roli:

- Garantimi i lidhjes në sistem të çdo prodhuesi të ri të energjisë elektrike apo bashkëprodhimit nga BRE,
- Vlerësimi i koston së lidhjes në sistem
- Përcaktimi dhe publikimi nga KOSTT (dhe OSSH) i rregullave standarde lidhur me ndarjen e shpenzimeve për instalimin e sistemeve, siç janë kyçjet në rrjet dhe përforsimet ndërmjet gjithë prodhuesve të energjisë elektrike që përfitojnë prej tyre.

### Burimet

Llojet e BRE-ve:

- energjia e ujit
- energjia e erës
- energjia diellore
- energjia gjeotermale
- biomasa dhe bogazi

### Potenciali dhe vendi i energjisë së ujit (Hidrocentralet e vogla)

Në bazë të studimeve të parafisibilitetit për burimet ujore për hidrocentrale te vegjël, në Kosovë janë identifikuar **77** lokacione, me kapacitet prej **128 MW**, dhe me prodhim vjetor prej **621 GWh**. Politika e Qeverisë së Kosovës është nxitja për ndërtimin e HC-ve të vogla me investime nga sektori privat, duke licencuar të drejtën për shfrytëzim të ujit për prodhim të energjisë.

Resursi	Studimet	Emertimi Name	Fuqia Capacity (MW)	Energjia Energy (GWh)	Lumi River
Hidro	Studimi i parafisibilitetit Janë identifikuar <b>16</b>	1.HCV. Kuqishtë	3.9	17	Lumëbardhi i Pejës
		2. HCV. Drelaj	6.2	27	
		3. HCV. Shtupeç	7.6	35	
		4. HCV. Belle	5.2	25	Lumëbardhi i

			5. HCV. Deçan	8.3	39	Deçanit			
			6. HCV. Lloçan	3.1	14	Lumëbardhi i Lloçanit			
			7. HCV. Mal	4.0	18	Erenik			
			8. HCV. Erenik	2.0	9	Lumëbardhi i Prizrenit			
			9. HCV. Jasiq	1.9	9.7				
			10. HCV. Reçan	1.5	6.7	Lepenc			
			11. HCV. Brezovicë	2.1	10				
			12. HCV. Lepenci	3.5	16	Banjskë			
			13. HCV. Bajskë	0.3	1.4				
			14. HCV. Batare	1.1	5.8	Bistrica (Batare)			
						15. HCV. Majanc	0.6	2.9	Kaçandoll
						16. HCV. Mirusha	4.6	22	Drini + L.Deçanit
						<b>Totali</b>	<b>55.90</b>	<b>258.5</b>	
			Vlerësimi i mëtejshëm i potencialëve për Hidrocentrale te vegjëlnë Kosovë, Viti 2009	Janë identifikuar 20 lokacione të mundshme për ndërtimin e HCV, Viti 2009	1. HCV.Radesha 1	0.753	3.66	Radesha	
2. HCV.Radesha 2	1.489	7.37			Restelica				
3. HCV.Restelica 1	0.532	2.51							
4. HCV.Restelica 2	1.399	6.74							
5. HCV.Restelica 3	1.087	5.35							
6. HCV.Restelica 4	0.318	1.56							
7. HCV.Restelica 5	1.498	7.37			Brod				
8. HCV. Brodi 1	0.81	3.9							
9. HCV. Brodi 2	1.109	5.37							
10. HCV. Brodi 3	1.062	5.13			Lepencë				
11. HCV. Brodi 4	1.44	6.97							
12. HCV. Lepenci 1	0.365	1.79							
13. HCV. Lepenci 2	0.547	2.61							
14. HCV. Lepenci 3	0.804	3.96							
15. HCV. Lepenci 4	1.72	8.4							
16. HCV. Lepenci 5	2.795	13.64							
17. HCV. Lepenci 6	2.768	13.34							
18. HCV. Lepenci 7	0.444	2.14							
19. HCV. Lepenci 8	0.526	2.45							
20. HCV. Lepenci 9	1.185	5.73							
		<b>Totali</b>	<b>22.652</b>	<b>109.99</b>					
Vlerësimi i mëtejshëm i notencialëve	Janë identifikuar 41 lokacione	1. HCV. Iber 1	0.24	1.219	Iber				
		2. HCV. Iber 2	0.557	2.841					
		3. HCV. Iber 3	0.63	3.249					
		4. HCV. Iber 4	0.39	1.964					
		5. HCV. Llapi 1	0.531	2.925	Llapi				

6.HCV. Klina 1	0.466	2.197	Klina
7. HCV. Klina 2	0.472	2.441	
8.HCV.Morava e Binçës 1	0.106	0.490	Morava e Binçës
9. HCV.Morava e Binçës 2	0.174	0.803	
10.HCV.Istogu 1	0.453	2.243	Istog
11.HCV.Nerodime 1	0.172	0.835	Nerodime
12. HCV.Nerodime 2	0.129	0.617	
13. HCV.Nerodime 3	0.120	0.600	
14.HCV.Çajlana 1	0.389	2.003	Çajlana
15.HCV. Drenica 1	0.112	0.549	Drenica
16.HCV.Reka e Aliagës 1	1.197	6.222	Reka e Aliagë
17. HCV.Reka e Aliagës 2	0.763	3.983	
18.HCV.Drini i Bardhë 1	2.032	11.875	Drini i Bardhë
19.HCV. Jabllanica	1.011	5.156	Lepenci
20.HCV.Lepenci II-1	3.585	17.536	
21. HCV.Lepenci II-2	2.814	15.050	
22. HCV.Lepenci II-3	6.070	30.363	Lumëbardhi i Perizrenit
23.HCV.Prizreni 1	1.145	5.787	
24. HCV.Prizreni 2	2.989	15.172	
25. HCV.Prizreni 4	2.525	13.040	
26. HCV.Prizreni 5	2.843	14.742	
27. HCV.Prizreni 6	1.193	5.992	
28. HCV.Prizreni 7	1.663	8.087	
29. HCV.Prizreni 8	1.775	8.855	
30. HCV.Prizreni 9	1.682	8.414	
31.HCV.Peja 4	0.768	3.892	
32. HCV.Peja 5	1.329	6.637	
33. HCV.Peja 6	1.196	6.004	
34. HCV.Peja 7	1.054	5.143	
35. HCV.Peja 8	0.927	4.520	
36. HCV.Peja 9	0.357	1.844	
37. HCV.Peja 10	1.715	8.538	
38. HCV.Peja 11	0.848	4.302	
39.HCV. Lloçani 1	0.672	3.614	Lumëbardhi i Lloçani
40. HCV. Lloçani 2	1.495	7.920	
41. HCV. Lloçani 4	1.056	5.659	

		<b>Totali</b>	<b>49.645</b>	<b>253.326</b>
		<b>Totali i studimeve 2006,2009&amp;2010</b>	<b>128.197</b>	<b>621.816</b>

### Potenciali dhe vendi i energjisë së erës

Përmes një projekti demonstrues, në afërsi të Prishtinës, në vitin 2009 janë instaluar tre gjeneratorë për prodhimin e energjisë nga era, me kapacitet 1.35 MW. Ndërkohë, në vitin 2010, qeveria zvicerane ka financuar vlerësimin e potencialit të energjisë së erës në disa zona të Kosovës, rezultati i të cilave është paraqitur në tabelën e mëposhtme.

Resursi	Studimet (Investitorprivat)	Emertimi Name	Shpejtësia mesatare e erës (m/s)
Ere	Vlerësimi i potencialeve të erës  NEK-Qeveria Zviceriane (AUK)	Lypjan	
		Lypjan	3.6
		Gjilan	3.3
		Therandë	7.0
		Therandë	4.4
		Klinë	3.8
		Abri e Epërme	4.6
		Prizren	3.4
		Kaçanik	4.1
		Rahovec	<b>5.3</b>

### Potenciali i energjisë diellore

Bazuar në pozitën gjeografike dhe kushtet klimatike të Kosovës, energjia diellore mund të shfrytëzohet në masë të konsiderueshme për ngrohjen e ujit sanitar. Prodhimi i energjisë fotovoltaike mbetet një opcion i mundshëm vetëm atëherë kur kostoja e saj do të vlerësohet si e përballueshme për tregun vendor.

Energjia nga biomasa dhe energjia gjeotermale

Në të ardhmen pritet të vlerësohet potenciali energjetik i biomasës dhe i energjisë gjeotermale.

## **Politika stimuluuese**

Feed-in tarifaf për BRE

- energjia e ujit: 63.3 Euro/MWh
- energjia e erës: 85 Euro/MWh
- Energjia nga biomasa dhe biogazi: 71.3 Euro/MWh

Blerja e obligueshme

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes është i obliguar ta blejë tërë sasinë e energjisë së prodhuar nga BRE.

## **Procedurat e autorizimit**

Disa prej dokumenteve (lejeve, pëlqimeve, vendimeve, kontratave, etj.), që nevojiten për marrjen e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE:

- Marrëveshja Kontraktuese mes Komunës përkatëse dhe investitorit
- Kontrata mbi Servitutin - e lidhur mes Komunës përkatëse dhe investitorit
- Vendimi mbi dhënien e pëlqimit - për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga BRE, lëshuar nga Komuna përkatëse;
- Pëlqimi për shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore - të lëshuar nga Agjencisë Pyjore të Kosovës, MBPZHR;
- Kontrata për shfrytëzim të përkohshëm të tokës pyjore – e lidhur mes Agjencisë Pyjore të Kosovës - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR)- dhe investitorit;
- Vendimi për Pëlqimin Mjedisor- lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
- Vendim për Lejen Ujore- lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
- Leja Urbanistike –lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH);
- Pëlqimi për masat për mbrojtje nga zjarri - i lëshuar nga Agjensioni i Menaxhimit Emergjent/ Ministria e Punëve të Brendshme;
- Leja e Ndërtimit – lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) nëse Gjeneratori është mbi 20 MW, ndërsa nën 20MW lejen e ndërtimit e lëshon Komuna përkatës (Drejtorati për Urbanizëm).

- Kontrata për kyçje në rrjetin e transmisionit apo distributionit, e lidhur mes Operatorit të rrjetit dhe investitorit.

Varësisht prej lokacionit ku do të ndërtohet gjeneratori i ri, mund të kërkohen edhe leje dhe pëlqime edhe nga institucionet tjera.